



Të Drejtat e Nëpunësit

Sipas Dekretit Kombëtar të Marrëdhënieve të Punës

Dekreti Kombëtar i Marrëdhënieve të Punës (NLRA) garanton të drejtën e nëpunësve të organizohen dhe të bëjnë marrëveshje kolektive me punëdhënësit e tyre, si dhe të ndërmarrin aktivitete të tjera të përbashkëta, sipas të drejtave të tyre, ose t'i shmangen fare aktiviteteve të përshkruara më lart. Nëpunësit e mbuluar nga NLRA* janë të ruajtur nga disa lloje shkeljesh që mund të bëhen nga punëdhënësi apo sindikata. Ky njoftim ju jep informacion të përgjithshëm mbi të drejtat që keni, si dhe mbi detyrimet që kanë punëdhënësit dhe sindikatat brenda NLRA-së. Kontaktoni Bordin Kombëtar të Marrëdhënieve të Punës (NLRB), e cila është agjensia Federale që zgjidh ankesat sipas NLRA-së, duke përdorur informacionin e dhënë më poshtë, në se keni pyetje për të drejtat që mund t'i përkasin vendit tuaj specifik të punës.

Sipas NLRA-së, keni të drejtën të:

- Organizoni një sindikatë për të bërë marrëveshje me punëdhënësin tuaj përsa i përket rrogave dhe orarit tuaj, si dhe kushteve të tjera të punësimit.
- Formoni, t'i bashkoheni apo të asistoni një sindikatë.
- Bëni marrëveshje së bashku me anë të përfaqësuesve të zgjedhur nga vetë nëpunësit për një kontratë me punëdhënësin që ka të bëjë me rrogat, përfitimet, orarin, si dhe kushtet e tjera të punës.
- Diskutoni për rrogat dhe përfitimet tuaja, si për dhe kushtet e tjera të punësimit apo për organizimin e sindikatave me kolegët tuaj ose me një sindikatë.
- Bëni hapa bashkë me një ose më shumë kolegë për të përmirësuar kushtet e punës, për të përmendur disa, nëpërmjet shprehjes së ankesave direkt me punëdhënësin ose me një zyrë qeveritare, si dhe duke kërkuar ndihmë nga sindikata.
- Bëni grevë dhe të protestoni, në varësi të qëllimit apo mjetit të grevës apo të protestës.
- Vendosni të mos ndërmerrni asnjë nga këto aktivitete, duke përfshirë anëtarësimin apo mbetjen si anëtar në një sindikatë.

Sipas NLRA-së, është e paligjshme për nëpunësin të:

- Ju pengojë të flisni apo të kërkonin një sindikatë jashtë orarit të punës, si për shembull përpara apo pas punës ose gjatë kohës së pushimit; ose të ju pengojë të shpërndani informacion mbi sindikatat jashtë orarit të punës, në vendet jashtë punës, si për shembull në hapësirën ku parkohen makinat apo në dhomat e pushimit.
- Ju bëjë pyetje për mbështetjen dhe aktivitetet tuaja në një sindikatë në mënyrë që t'ju bëjë të heqni dorë nga ai aktivitet.
- Ju pushojë nga puna, t'ju ulë nga posti që keni, apo t'ju transferojë, ose të ulë numrin e orëve apo të ndërrojë turnet, ose të ndërmarrin masa të pafavorshme kundra jush, ose të kërcënojnë marrjen e këtyre masave të sapo përmendura, për arsye se ju jeni futur apo mbështesni një sindikatë, ose sepse jeni përfshirë në aktivitete të përshbakëta për të gjetur ndihmë apo mbrojtje, ose sepse vendosni të mos përfshihen në aktivitete të tilla.
- Ju kërcënojnë mbylljen e vendit tuaj të punës në se punëtorët vendosin të përfaqësohen nga një sindikatë.
- Premtojnë apo të japi promovime, shtesa rroge, apo përfitime të tjera me qëllim dekurajimin apo inkurajimin e mbështetjes së sindikatave.
- Ju ndalojnë veshjen e kapeleve, kopsave, këmishave apo karficave të sindikatës suaj në vendin e punës, përveç rasteve të veçanta.

- Spiunojë apo regjistrojë me video aktivitete dhe grumbullime paqësore të sindikatave apo të bëjë sikur po spiunon apo regjistron.

Sipas NLRA-së, është e paligjshme për një sindikatë apo për sindikatën që ju përfaqëson gjatë marrëveshjeve me punëdhënësin tuaj të:

- Ju kërcënojë apo detyrojë të mbështetni sindikatën.
- Refuzojë të shqyrtojë ankesat për arsye se ju keni kritikuar zyrtarët e sindikatës ose sepse nuk jeni anëtar i sindikatës.
- Përdor ose mbartë standarte apo procedura diskriminuese në dhëniet e referencave të punës nga organizata sindikaliste e punës.
- Bëjë apo të përpiqet të bëjë një punëdhënësi të diskriminojë kundër jush për shkak të aktiviteteve tuaja në sindikatë.
- Marri masa të disfavorshme ndaj jush për arsye se ju nuk jeni regjistruar apo nuk mbështetni sindikatën.

Në se ju dhe kolegët tuaj zgjidhni një sindikatë si përfaqësuese të përbashkët për të bërë marrëveshje, punëdhënësi juaj dhe sindikata janë të detyruar të bëjnë marrëveshje me mirëbesim duke u përpjekur sinqerisht të bien dakort me zë dhe me shkrim, duke vendosur kushtet e punësimit tuaj. Sindikata është e detyruar t'ju përfaqësojë drejtësisht gjatë procesit së arritjes së marrëveshjes dhe të zbatimit të saj.

Sjellja jashtë ligjit nuk do lejohet. Në se besoni se të drejtat tuaja ose të drejtat e të tjerëve janë abuzuar, duhet të kontaktoni NLRB-në sa më parë që të mbronin të drejtat tuaja, pak a shumë brenda gjashtë muajsh pas aktivitetit të paligjshëm. Mund të pyetni për thyerje të mundshme ligjore pa u informuar punëdhënësi apo ndokush tjetër që e keni bërë një kërkesë të tillë. Akuzat mund të bëhen nga çdokush dhe nuk ka nevojë të bëhen nga nëpunësi i cili është viktimë direkte e thyerjes ligjore. NLRB mund të urdhërojë punëdhënësin të ripunësojë një punonjës i cili është pushuar nga puna në mënyrë të paligjshme, si dhe ta detyrojë punëdhënësin të paguaj rrogën dhe përfitimet e humbura, si dhe mund të urdhërojë një punëdhënësi apo sindikatë të mos ta shkeli më ligjin. Nëpunësit duhet të kërkojnë ndihmë nga zyra NLRB rajonale më e afërt, e cila mund të gjendet në faqen e internetit të Agjensisë: <http://www.nlrb.gov>.

Gjithashtu mund të kontaktoni NLRB-në duke telefonuar falas: **1-866-667-NLRB (6572)** ose (TTY) **1-866-315-NLRB (1-866-315-6572)** për ata që nuk dëgjojnë.

If you do not speak or understand English well, you may obtain a translation of this notice from the NLRB's Web site or by calling the toll-free numbers listed above.

*Dekreti Kombëtar i Marrëdhënieve të Punës mbulon shumicën e punëdhënësve të sektorit privat. Përfshihen nga ky mbulim i NLRA-së nëpunësit e sektorit publik, punëtorët bujqësor dhe shtëpiak, kontraktuesit e pavarur, punëtorët e punësuar nga një prind apo bashkëshort, nëpunës të mjeteve ajrore dhe hekurudhore të cilët mbulohen nga Dekreti i Punës së Hekurudhave dhe drejtuesit (megjithëse drejtuesit që janë diskriminuar sepse kanë refuzuar të shkelin rregullat e NLRA-së mund të mbulohen).

Ky është Njoftim Qeveritar zyrtar dhe nuk duhet të shtrembërohet nga askush.